



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYETARI
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

Adresa: Rruga "AbdiToptani" Nr.1 Tiranë E-mail: klsh.org.al; [ebsite:ëëë.klsh.org.al](http://ebsite.ee.klsh.org.al)

Nr. 935/5 Prot.

Tiranë, më 03.12.2018

V E N D I M

Nr. 184, Datë 03.12.2018

**PËR
AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË, TË USHTRUAR NË
BASHKINË VORË**

Për periudhën 01.07.2016 – 30.09.2018.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, nisur nga fakti se nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Vorë, për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë për procedurat e prokurimit për periudhën 01.07.2016 – 30.09.2018, rezultoi se pasqyrat financiare japin një pamje të kujdesshme të performancës së Bashkisë Vorë, pavarësisht se konstatuam disa mangësi, të cilat duhet të përmirësohen dhe për zbatimin e të cilave, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Vorë, sipas programit të auditimit numër 935/1prot., datë 01.09.2018, për veprimtarinë nga data 01.07.2016 – 30.09.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i pakualifikuar mbi pasqyrat financiare me “Theksim të çështjes”.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Vorë për vitin ushtrimor, nga 1 Janar 2017 deri 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (hyrjeve dhe daljeve (pagesave) në para, pasqyra e amortizimit, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë

testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të sigurtë të pozicionit financiar të performancën financiare dhe lëvizjet e mjeteve monetare për Bashkinë Vorë më 31.12.2017, kjo referuar Ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Udhëzimit të Minsitrisë së Financave “Për procedurat e përgatitjes dhe mbylljes së paqyrave financiare për institucionet qendrore, njësitë e qeverisjes vendore, njësitë e tyre të varësisë dhe njësitë e zbatimit/implementimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë huaj”, përveç aspekteve që adresohen në bazën për theksim të çështjes.

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat nuk janë materiale, dhe nuk kanë ndikim të dukshëm mbi nivelin e materialitetit dhe në vendimmarrjen e përdorueseve të pasqyrave financiare.

“Theksimi i çështjes” konsiston në rastin e përlogaritjes së amortizimit në vite të aktiveve (në veçanti të pajisjeve kompjuterike), duke krijuar një vlerë të nënvlerësuar të të këtij aktivi, të trajtuar gjerësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Nga të dhënave zyrtare konstatohet se posedues të lejes së legalizimit pa paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë janë 459 subjekte, për sipërfaqe ndërtimore 118,586 m², me një efekt në vlerën 35 milion lekë. Kjo vlerë nuk është pasqyruar si detyrim në bilancin e viteve ushtrimore 2016 e 2017, duke nënvlerësuar zërin e të debitorëve për taksa e tarifa vendore.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Vorë

Ne kemi audituar përputhshmërinë e subjektit me ligjet dhe rregulloret në lidhje me realizimin e procedurave të prokurimit, dhe shpenzimet/investimet vjetore të buxhetit, nga ana e Bashkisë Vorë. Në opinionin tonë, për shkak të rëndësisë së çështjeve të përmendura në bazën për opinionin e përputhshmërisë, transaksionet e kryera për zbatimin e buxhetit dhe prokurimeve, nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor financiar në fuqi.

Kemi konstatuar se nga ish-komunat Prezë dhe Bërçull janë trashëguar fatura të pa likuiduara për investime, pjesë e pa financuar nga FZHR në vlerën prej 48 milion lekë, megjithëse këto vepra janë përfunduar dhe janë marrë në dorëzim. Duhet të theksojmë se këto shpenzime kanë zënë rreth 8% të fondeve vjetore të bashkisë. Nga FZHR nëpërmjet Ministrisë së Financave nuk janë akorduar fonde për likuidimin e këtyre faturave deri më datë 31.10.2018.

Nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Tarifave Vendore, nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore të legalizuara nga ALUIZNI-Drejtoria Rajonale Kamëz-Vorë. Sipas të dhënave zyrtare konstatohet se deri më 30.09.2018, janë posedues të lejes së legalizimit pa paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë 459 subjekte (422 subjekte objekt i parë dhe 37 subjekte objekt i dytë) për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 118,586 m² (99,021 m² objekt i parë dhe 19,565 m² objekt i dytë), me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vorë në vlerën 35 milion lekë. Kjo vlerë nuk është pasqyruar si detyrim në bilancin e viteve ushtrimore 2016 e 2017.

Në zbatimin e dy kontratave u konstatuan devijime materiale në zërat e matshëm të

punimeve, fakt që tregon se mbikëqyrja e punimeve të investimeve është një zonë me risk në menaxhimin e investimeve publike. Kështu në procedurën me objekt “Sistemim asfaltim i rrugëve Hasramëve dhe Tarucëve dhe KUZ rruga e Tarucëve, Muçaj, Bashkia Vorë”, fituar nga BOE “D P 2007” shpk & “R 2008” shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 176,119 lekë pa tvsh, vlerë që përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Ndërsa, nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim Liqenit, Segmenti Gurrez, Segmenti Muhajes dhe segmenti Zajza”, Njësia Administrative Bërçullë”, Bashkia Vorë, fituar nga OE “B-I” shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 669,085 lekë pa tvsh.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standarteve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Vorë

Drejtimi i Bashkisë Vorë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Staf i drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH

mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Vorë, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen jo plotësisht. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Është hartuar rregullorja e funksionimit të njësisë, pjesë e së cilës është edhe kodi i etikës. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultoi se:

-Në lidhje me mjedisin e kontrollit. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh.

-Në lidhje me menaxhimin e riskut: Nuk ka të miratuar një strategji të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut sipas nenit 21. Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

-Në lidhje me informacionin dhe komunikimin: Në rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprohej me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqet 16 -17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Vorë, nëpërmjet Nëpunësit Autorizues dhe strukturës së Auditit të Brendshëm, të marren masa për njohjen nga menaxhimi dhe stafi i MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Në vijimësi.

2. Gjetje nga auditimi: NJAB në ushtrimin dhe realizimin e funksionit të saj nuk ka vlerësuar si duhet riskun dhe aktiviteti i saj ka qënë i limituar për sa kohë plani i auditimeve është realizuar në masën 80%. Në të gjitha rastet, nuk është bërë kontrolli i cilësisë së auditimit të kryer në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm i miratuar me Urdhër të Ministrave të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kap. II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqet 17 -19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Vorë të merren masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

Në vijimësi.

3. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të bilancit dhe pasqyrës së amortizimit, gjendja e llogarisë 219 “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara” paraqitet me një vlerë prej 1,064,891,427 lekë, e cila është llogaritur mbi vlerën vjetore të AQT prej 175,445,650 lekë të pasqyruar në bilanc, sipas normave ligjore të miratuara për çdo grup të klasifikimit. Ndërsa për AQT e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” me gjendjen kontabël prej 63,849,526 lekë në të cilën përfshihen pajisjet kompjuterike në vlerën 15,594,946 lekë, vlera e amortizimit është llogaritur 25% mbi vlerën totale të këtyre pajisjeve dhe jo 25% mbi vlerën e mbetur, duke krijuar një vlerë të nënvlerësuar të aktivitetit dhe për rrjedhojë edhe të

fondit bazë edhe të pasivit të bilancit kontabël, (**Aneksi nr.1**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit), në kundërshtim me UMF nr.14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njëjstëve që varen prej tyre”, ndryshuar Kreu II pika 1/4 “Amortizimi vjetor” dhe me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqet 19 -20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Bashkia Vorë nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të marrë masa për përllogaritjen e saktë e amortizimit që nga viti i parë i përdorimit e deri në momentin aktual dhe të bëjë korrigjimin e vlerës së mbetur të paraqitur në bilancet e viteve të mëparshme të kësaj llogarie, duke bërë veprimet e sistemit kontabël në mbylljen e bilancit të vitit 2018.

Brenda muajit shkurt të vitit 2019

4. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të pasqyrave financiare të vitit 2017 gjendja e debitorëve të pasqyruara në aktivin e bilancit është në vlerën 78,494,360 lekë e ndarë:

-Gjendja e llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba”, është në vlerën kontabël 683,556 lekë detyrime të 25 punonjësve të administratës të ish-komunës Bërxull të konstatuar nga auditimi i KLSH për periudhën viti 2014 dhe të pa arkëtuara.

-Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” është vlerën 77,890,804 lekë, e cila ka analizë për 297 subjekte juridike dhe fizike të ndara në tre kategori: Kategoria e parë janë “debitorë të taksave dhe tarifave vendore” në vlerën 57,315,979 lekë për Bashkinë Vorë dhe në vlerën 18,731,163 lekë nga ish-komuna Bërxull. Kategoria e dytë janë “debitorë nga sektori financiar” në vlerën 1,508,862 lekë, e cila përfaqëson ndalesat për pagesat e këshilltarëve bashkiakë të konstatuara nga auditimi i mëparshëm i KLSH për periudhën 2014-2015. Kategoria e tretë janë “Debitorë për ujësjellësin” në 334,800 lekë për periudhat para viteve 2015. Mos ndjekja dhe mos arkëtimi i detyrimeve të debitorëve është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, nenin 12.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqet 20 -21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1.Rekomandim: Bashkia Vorë të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve, duke klasifikuar ato me shpresë arkëtimi dhe përcaktuar vlerën e tyre, duke iu referuar listave analitike bashkëlidhur pasqyrave financiare të vitit 2017.

Menjëherë.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2017 dhe dokumentacioni mbështetës i tyre konstatohet se detyrimet afatshkurtra në llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” janë në vlerën **66,297,782 lekë**, për blerje mallra e materiale të ndryshme si dhe punime të kryera për investime. Nga këto janë trashëguar nga ish-komunat Prezë dhe Bërxull fatura të pa likuiduara për investime, gjendje e mbetur e pa financuar nga FZHR në vlerën prej 48,057,992 lekë ose në masën 9% të shpenzimeve, pavarësisht kërkesave nga Bashkia Vorë për vazhdimin dhe përfundimin e financimit, pasi këto vepra janë përfunduar dhe janë marrë në dorëzim. Nga FZHR nëpërmjet Ministrisë së Financave nuk janë akorduar fonde për likuidimin e këtyre faturave deri më datë 31.10.2018. Ndërsa vlera prej 18,239,860 lekë për fatura të pa likuiduara për blerje mallrash dhe shërbimesh pjesë e gjendjes kontabël në bilancin e vitit 2017 është pakësuar në vlerën 8,629,182 lekë nga likuidimet në vazhdim të vitit 2018 dhe vlera e mbetur e pa likuiduar në fund të 9-mujorit të këtij viti është 9,610,678 lekë, veprim në papajtueshmëri me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenin 12, -

Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues, shkronja gj) ku përcaktohet: *Nëpunësi zbatuesgaranton që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mospagesë nga kreditorët, nëpunësi zbatues duhet t'ia shpjegojë rrethanat nëpunësit autorizues. (Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqet 21 -22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandim: Bashkia Vorë (Drejtoria Financë Buxhetit), bazuar në udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” dhe Udhëzimin plotësues nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, *Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën **66,297,782 lekë**, si dhe të nxirret përgjegjësia për këto vonesa.

Në mbledhjen me të afërt të Këshillit Bashkiak.

6. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Vorë dhe Njësitë Administrative Prezë dhe Bërxull në fund të vitit 2017 janë debitorë për taksa dhe tarifa vendore për 60 subjektet e biznesit të vogël në vlerën 2,443,072 lekë dhe 21 subjekte të biznesit të madh në vlerën 87,438,736 lekë dhe familjarët në vlerën 8,317,400 lekë që përbëhet nga (8034 familje për taksë toke në vlerën 1,773,900 lekë, 9870 familje për taksë ndërtese në vlerën 1,211,100 lekë, taksë pastrimi dhe ndriçimi për 8956 familje në vlerën 5,332,400 lekë). Vlerën më të lartë të detyrimeve në shumën 69,147,018 lekë, e ka subjekti “C P”, me të cilin bashkia është në procese gjyqësore. Sektori i Tatim Taksave për arkëtimin e debitorëve nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32 dhe 34 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 90 dhe 91 të ligjit nr. 9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 12, me Udhëzimin Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI. *(Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqet 22 -23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Bashkia Vorë, nëpërmjet Drejtorisë së Tatim Taksave e Tarifave të marrë masa, për arkëtimin e detyrimeve tatimore të pa arkëtuara në vlerën 89,881,808 lekë për sektorin e biznesit dhe të vlerës 8,317,400 lekë nga familjarët, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar.

Sa sipër, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Drejtoria e Taksave të nxirren njoftim vlerësimet tatimore dhe për arkëtimin e detyrimeve të mësipërme të ndiqen **rrugët e mëposhtme:**

a) T’u ridërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar *(Në rast mos kryerjes të urdhër bllokimeve prej bankave të njoftohet Guvernatori i Bankës Shqipërisë).*

b) T’i ridërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

c) Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të fillojë llogaritja e gjobës në masën 0,06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më tepër se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, me ligjin nr.164/2014, datë 15.12.2014.

ç) Në se edhe pas njoftimeve zyrtare Bizneset nuk pranojnë të paguajnë detyrimet e akumuluar në vite, nga ana e Bashkisë (Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike) të

marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të Republikën e Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, -*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*.

d) Drejtoria e Taksave në Bashkinë Vorë të listojë në mënyrë elektronike abonentëfamiljarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të familjarëve, taksës së tokës nga fermerët e 2 Njësive Administrative. Në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, pika 76, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë dhe bizneset me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimi me anë të zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifatat etj.

Në vijimësi.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të menaxhimit të aseteve u konstatua se janë lidhur në 3 raste kontrata qiraje për dhënie truall në përdorim pronë e bashkisë për zhvillim aktiviteti biznesi. Vetëm në rastin e kontratës së lidhur me subjektin “AD” për dhënie truall prej 9240 m² për aktivitet “tregtim bimë medicinale” me afat 99 vjeçar nuk është bërë pagesa, duke mos shlyer detyrimin kontraktor në shumën 9147 USD për 3 vitet 2016, 2017 dhe 2018, në kundërshtim me kontratën e datës 01.06.1994. Sipas kësaj kontrate parashikohet 1% kamatëvonesë për çdo ditë vonesë të pagesës së tarifës së qirasë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqen 24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Vorë, nëpërmjet Drejtorisë Juridike të marrëmasa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktor prej 9,147 USD nga subjekti privat “AD” të krijuar nga mos pagesa e tarifës së qirasë për tre vitet e fundit të përcaktuar në kontratën e qiradhënies datë 01.06.1994.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Vorë, Drejtoria e të Ardhurave dhe Tarifave Vendore, nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Kamëz -Vorë. Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Vorë, konstatohet se deri më 30.09.2018, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 459 subjekte (422 subjekte objekt i parë dhe 37 subjekte objekt i dytë) për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 118,586 m² (99,021 m² objekt i parë dhe 19,565 m² objekt i dytë), jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar dhe Vendimi i Këshillit të Bashkisë (VKB) nr.50, datë 11.02.2016, nr.61, datë 30.12.2016, nr.101, datë 22.12.2016 dhe nr.75, datë 26.12.2017, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 35,050,126 lekë. Kjo vlerë nuk është përfshirë në llogaritë debitore dhe nuk është pasqyruar në bilancin e viteve ushtrimore 2016 e 2017. *(Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqet 24 -25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Vorë, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe në bashkëpunim me ALUIZNI-Kamëz dhe ZVRPP Tiranë të merren masa të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar si dhe të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së infrastrukturës në vlerën 35,050,126 lekë, sipas listave të debitorëve bashkëlidhur në Aneksin nr.1 të Projekt Raportit të Auditimit.

9. Gjetje nga auditimi: Realizimi i rekomandimeve dhe detyrave të lëna nga KLSH, paraqitet si më poshtë

Masa organizative janë ri kërkuar 7 masa organizative, prej të cilave janë zbatuar plotësisht 3 prej tyre dhe janë në proces zbatimi 4 masa. Masat organizative në proces zbatimi janë si më poshtë:

- **Rekomandimi 6**, për objektin sipas kontratës datë 01.06.1994 lidhur ndërmjet shoqërisë “A-D M” dhe Degës së Agjencisë së Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore Tiranë. Bashkia Vorë, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë padi Nr.3895 Prot., datë 25.07.2018 për zgjidhjen e kësaj çështje dhe është në pritje të vendimit të gjykatës.

- **Rekomandimi 7**, për objektin sipas kontratës Datë 19.12.1992 lidhur ndërmjet shoqërisë së ndërtimit “KA” përfaqësuar nga HW E dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshillit të Rrethit Tiranë dhe Kryetarit të Këshillit të Komunës Vorë, Bashkia Vorë i është drejtuar Gjykatës me kërkesë padinë nr. 3894 prot., datë 25.07.2018 për zgjidhjen e kësaj çështje dhe është në pritje të vendimit të gjykatës.

- **Rekomandimi 15:** Nga auditimi i Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore, rezultoi se për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë (subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe taksat e tarifave familjare), **në vlerën prej 78,295 mijë lekë** gjithsej, rezultoi se vlera e debisë prej **78,295 mijë lekë deri më datën 30.09.2018** është ulur me **29,798 mijë lekë**.

Nga 52 subjekte debitorë që i përkasin biznesit të madh në vlerën prej **53,575,704 lekë** (debi e akumuluar në vitet 2014 – 2016) është arkëtuar vlera prej **7,973,870 lekë**, kanë përfituar nga falja me ligjin 33/2017, datë 30.03.2017, 2 subjekte me vlerë debie **305,882 lekë** dhe kanë mbetur për tu arkëtuar edhe debia e 29 subjekteve të biznesit të madh në vlerën **45,295,952 lekë**.

- **Rekomandimi 16**, janë nxjerrë urdhër ekzekutimet nga sektori Juridik janë lidhur marrëveshjet me përmbaruesin privat për ekzekutimin e këtyre vendimeve. Në rastet kur subjektet nuk kanë bërë pagesat e gjobave u është llogaritur kamatëvonesa prej 2%/muaj bazuar në ligjin Nr. 10279 dt. 20.05.2010 “Për kundra vajtjet Administrative”, Neni 30.

Masa shpërbllim dëmi: Nga tre masa për shpërbllim dëmi, të ri kërkuara një është zbatuar dhe dy janë në proces zbatimi, sa vijon:

-**Rekomandimi 5:** Zyra e Financës në Bashkinë Vorë të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **193,440 lekë, nga 15 këshilltarët**, kanë mbetur pa likuiduar 118,980 lekë. Për personat të cilët nuk kanë likuiduar edhe pse kanë marrë njoftimin e detyrimit Bashkia Vorë po ndjek hapat ligjor për arkëtimin e tyre. Të dhënat analitike janë sipas **ANEKS E/4** bashkëlidhur.

- **Rekomandimi 6:** Për objektin sipas kontratës datë 01.06.1994 lidhur ndërmjet shoqërisë “AD M” përfaqësuar nga E G dhe Degës së Agjencisë së Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore Tiranë nuk është paguar detyrimi prej **3,049 USD ose 391,156 leke**, ky institucion i është drejtuar Gjykatës me kërkesë padi Nr.3895 Prot., datë 25.07.2018 për zgjidhjen e kësaj çështje dhe është në pritje të vendimit të gjykatës.

Masa administrative KLSH i ka rekomanduar Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Vorë që të vendosë masë administrative me gjobë ndaj 2 mbikëqyrësve të punimeve në vlerën gjithsej prej 150,000 lekë. Bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Disiplinimin e Punimeve në Ndërtim”, neni 16, gjoba duhet të ishte paguar brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati është llogaritur për tu paguar kamata 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën E, faqet 30 -32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Bashkia Vorë të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke nxjerrë përgjegjësinë si dhe duke ndjekur procedurat administrative dhe ligjore.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI :

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **845,204 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Sistemim asfaltim Liqenit, Segmenti Gurrez, Segmenti Muhajes dhe segmenti Zajza”, Njësia Administrative Bërxullë”, Bashkia Vorë*, me vlerë të kontratës 52,915,360 lekë me tvsh, fituar nga OE “B-I” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **669,085 lekë** pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5362/1, datë 20.10.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Vorë dhe OE “B-I” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqet 27 -28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vorë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 669,085lekë pa tvsh nga OE “B-I” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 5362/1, datë 20.10.2017 me objekt *“Sistemim asfaltim Liqenit, Segmenti Gurrëz, Segmenti Muhajes dhe segmenti Zajza”, Njësia Administrative Bërxullë”, Bashkia Vorë*, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera dhe vonesave në përfundimin e punimeve.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Sistemim asfaltim i rrugëve Hasramëve dhe Tarucëve dhe KUZ rruga e Tarucëve, Muçaj, Bashkia Vorë”,* me vlerë të kontratës 39,342,767 lekë, fituar nga BOE “D P 2007” SHPK & “R 2008” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **176,119 lekë pa tvsh**, vlerë që përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 156/5 prot datë 30.06.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Vorë dhe BOE “D P 2007” SHPK & “R 2008” SHPK *(Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqet 28 -30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vorë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **176,119lekë pa tvsh** nga BOE “D P 2007” SHPK & “R 2008” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 156/5 prot datë 30.06.2017, me objekt *“Sistemim asfaltim i rrugëve Hasramëve dhe Tarucëve dhe KUZ rruga e Tarucëve, Muçaj, Bashkia Vorë”,* vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vorë t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative 50,000 lekë gjobëpërnjë mbikëqyrës dhe një kolaudator punimesh**, si më poshtë:

1. Z. V T, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin “Sistemim asfaltim Liqenit, Segmenti Gurrëz, Segmenti Muhajes dhe segmenti Zajza”, Njësia Administrative Bërxullë”, Bashkia Vorë, me sipërmarrës punimesh OE “B-I” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 669,085lekë me tvsh si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

2. Z. F L, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin “Sistemim asfaltim Liqenit, Segmenti Gurrëz, Segmenti Muhajes dhe segmenti Zajza”, Njësia Administrative Bërxullë”, Bashkia Vorë, me sipërmarrës punimesh OE “B-I” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 669,085lekë me tvsh si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

E. MASA DISIPLINORE

Nuk rekomandojmë masa disiplinore për arsye se shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit nuk përbëjnë bazë materialiteti për dhënie mase disiplinore si dhe konstatimet janë të korrigjueshme.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R